



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 27.05.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 , nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit të Bordit të Drejtorëve 01 nr.06-20304-13/2 i dt:13.03.2015, pas shqyrtimit të kërkesës së koordinatorit për kthim në ZKKK të dt: 05.05.2015 për vazhdimin e pagesës së qirasë edhe për 6 muaj për familjen e riatdhesuar të znj. Halise Behluli nga Gjakova, me dt: 27.05.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e cila është e ndërlidhur me kërkesën nr. 16-400-35413 e dt: 22.05.2015, e parashtruar nga znj. Halise Behluli nga Gjakova për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së banesës në vlerë prej 100€ në muaj, për afatin kohor prej 6 muajve, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të ZKKK në vlerën totale prej 600€ .

2. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerë prej 100€ në muaj për periodën prej 6 muajve, sipas kërkesës së ZKKK-së të dt: 05.05.2015, Përfundimit 01 nr. 06-20304-13/2 i dt: 13.03.2015 dhe kontratës për shfrytëzimin e banesës me qira të dt: 01.04.2015 .

3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 100€ në muaj, përkatësisht vlerën totale prej 600€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e qiradhënëses znj. Albina Fila nga Gjakova, nr. 1140165087000129 ProCredit Bank .

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

5. Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Znj. Halise Behluli nga Gjakova
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila